



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900106/4

Tiranë ___/___/2019

Lënda : *Rekomandim për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit të policisë Arben Pjeçi, efektiv i Komisarariatit të Policisë Durrës.*

DREJTORIT TË DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Durrës

Në institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar me iniciativë rasti i bërë publik në media nga ish Kryeministri z. Berisha, i cili bën fjalë për shoqërimin e 4 studentëve në Komisariatin e Policisë Durrës për shkak se kanë debatuar me Kryeministrin në rrjetet sociale. Preteksti i shoqërimit të tyre për 9 orë ka qënë se u kapën duke xhiruar një film me metrazh të shkurtër dhe kishin një pistoletë lodër. Ndërsa prindërin e njërit prej tyre, i cili ka vënë në dijeni ish Kryeministrin, e kishte ndaluar policia për arsye kot dhe i kërkonin se ku e kishte djalin. Ndërkohë prindi në fjalë i shkruante ish Kryeministrin se disponon edhe regjistrimin që Kryeministri shantazhon djalin e tij në telefon.

Me urdhër të Avokatit të Popullit dy ndihmëskomisionerë të institucionit tonë, në datën 21.01.2019 shkuam në Komisariatin e Policisë Durrës për verifikimin e këtij rasti. Nga pyetja e drejtuesve të Komisarariatit të Policisë Durrës dhe e punonjësve të policisë që kishin bërë shoqërimin e shtetasve të fjalë dhe e OPGJ-së që kishte punuar me ata, këqyrja dhe administrimi i dokumentacionit përkatës rezultoi se, në datën 19.01.2019 katër shtetasit Erges Mrruku, Ali Gjokola, Olsi Boja, të cilët janë student dhe shoku i tyre Mateos Abazi kishin organizuar me njëri-tjetrin dhe planifikuar që të bënin një film me metrazh të shkurtër (Video) tek "Vila e Zogut" në qytetin e Durrësit, për sensibilizimin e rinisë për të qëndruar larg armëve. Për të arritur këtë qëllim ata kishin gjetur një çakmak në formë pistoletë që i ngjante armës së vërtetë. Gjatë xhimit me "armë" në dorë, ata kanë rënë në sy të shtetasve të ndryshëm. Një shtetase ka njoftuar Komisariatin e Policisë Durrës duke i thënë se, tek "Vila e Zogut" janë 4 persona të cilët kanë një mjet dhe njëri prej tyre mban një pistoletë në dorë. Nga Komisariatin janë marrë masat e nevojshme dhe janë dërguar në vend dy patrulla policie. Punonjësit e policisë pasi kanë rrethuar vendin ku ndodheshin personat në fjalë, i kanë kapur ata dhe i kanë pyetur në lidhje me veprimet që po kryenin. Ata kanë shpjeguar se ishin duke xhiruar një film me metrazh të shkurtër dhe se "pistoleta" ishte lodër dhe jo e vërtetë. Pas kësaj punonjësit e policisë kanë bërë shoqërimin e të katër personave në komisariat për verifikime të mëtejshme. Sapo janë dërguar në komisariat, është ngarkuar që të punojë me ta oficeri i policisë gjyqësore (OPGJ) Arben Pjeçi, i cili u pyet me procesverbal nga punonjësit tanë. Ai pasi shpjegoi

ngjarjen në fjalë deklaroi se kishte kryer veprimet me ta duke u marrë deklarime, kishte bërë sekuestrimin e “pistoletës” së kapur dhe kishte kërkuar kryerjen e ekspertimit teknik të saj. Ndërkohë dokumentat e administruara i kishte referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për vlerësim në dt. 21.01.2019. Gjithashtu z. Pjeçi deklaroi se në datën 19.01.2019 në qytet kishte pasur disa ngjarje me të cilat kishte kryer veprime ai, sepse ishte i gatshëm dhe se gjatë kësaj dite kishte bërë veprimet procedurale duke bërë arrestimin e dy personave për një rast dhe për një rast tjetër autori i dyshuar i ngjarjes ishte ndjekur në gjendje të lirë. Pasi kishte kryer veprimet me rastet në fjalë, kishte marrë deklaratimet personave të shoqëruar dhe për shkak të ngarkesës së punës ata ishin mbajtur në gjendje shoqërimi 9 orë.

Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, u konstatua se OPGJ Arben Pjeçi i cili ishte ngarkuar dhe kishte kryer veprimet me katër të shoqëruarit, nuk kishte mbajtur e dhënë atyre “Procesverbalin mbi veprimet e kryer me të shoqëruarin”. Sipas tij, ai nuk e dinte që në të tilla raste mbahej ky dokument në dy kopje dhe njëra prej tyre i jepej të shoqëruarit.

Pas verifikimeve të bëra në komisariat, punonjësit tanë kontaktuan në telefon me tre prej të shoqëruarve respektivisht Mateos Abazi, Ali Gjokola dhe Erges Mrruku, ndërsa Olsi Boja nuk u përgjigj. Shtetasi Mateos Abazi deklaroi se shoqërimi i tyre ishte bërë për shkak të “pistoletës” që kishin përdorur gjatë xhirimit të filmit dhe se nuk kishte asnjë pretendim për sjelljen e policisë në këtë rast, si dhe kërkoj që rasti të mos bëhet publik. Shtetasi Ali Gjokola, me të cilin u morë takim personalisht dhe u pyet me procesverbal, deklaroi faktin se shkak i shoqërimit të tyre ishte “pistoleta” që ata kishin pasur me vete tek “Vila e Zogut” dhe jo debati i bërë me Kryeministrin, sikurse ishte publikuar me media. Gjithashtu ai deklaroi se në polici nuk ishin pyetur për ndonjë debat të bërë me Kryeministrin në rrjetet sociale.

Ndërsa shtetasi Erges Mrruku, i cili u kontaktua në telefon në datën 21.01.2019, por meqënëse nuk ndodhej në Durrës, u pyet në institucion tonë në datën 22.01.2019. Ai deklaroi se ishte student në Universitetin jo Publik “Marin Barleti” Tiranë. Verbalisht në bisedë të lirë tha se, shkak i shoqërimit të tyre në polici në datën 19.01.2019 ishte pasja me vete gjatë xhirimit të pistoletës lodër (çakmak) dhe jo debati me Kryeministrin në rrjetet sociale. Ndërkohë ai pohoi se në datën 13.01.2019 kishte pasur një komunikim, debat, me Kryeministrin Edi Rama në WhatsApp ku i kishte thënë që, “ti përgjigjej pyetjeve të studentëve”. Sipas tij, z. Rama e ka marrë në telefon dhe i ka thënë se “do të vij të gjej se ku je”. Megjithatë ai deklaroi se, pas 30 minutash nga telefonata me Kryeministrin, një punonjës i Komisarariatit të Policisë Durrës e kishte marrë në telefon babanë e tij dhe i kishte kërkuar që të shkonte në komisariat. Ai kishte shkuar në komisariat dhe kur ishin takuar me punonjësin e policisë, ky i fundit e kishte pyetur për Egërsin se ku ishte. Babai i kishte thënë atij që djali i tij Egërsi ishte student në Tiranë dhe me kaq ishte mbyllur kjo punë. Ergesi me shkrim deklaroi se nuk dëshironte që ky rast të ndiqej nga institucioni ynë dhe kërkoj që të mbyllet, sepse kjo çështje nuk ishte aq e rëndësishme dhe se ai e konsideronte të mbyllur. Gjithashtu ai deklaroi se kishte gabuar me Kryeministrin, sepse nuk kishte komunikuar në mënyrë korrekte me atë dhe se babai i vet e kishte njoftuar ish Kryeministrin pa dijeninë e tij.

Ndërkohë atij iu tha që të bisedonte me të atin dhe ti thoshte lidhur me ndjekjen e këtij rasti nga institucioni ynë dhe nëse do të dëshironte mund të vinte e të pyetej nga punonjësit tanë. Mirëpo ndonëse kanë kaluar disa muaj ai nuk ka ardhur për të dhënë shpjegime lidhur me këtë rast.

Pavarësisht faktit që 4 personat e përmendur me sipër nuk kishin pretendime lidhur me shoqërimin e tyre në komisariat dhe për sjelljen e punonjësve të policisë, ne gjykojmë se konstatimi i bërë lidhur me mos mbajtjen dhe për rrjedhojë edhe mos dhënien shtetasve të shoqëruar të “Procesverbalit mbi veprimet e kryer me të shoqëruarin” nga OPGJ Arben

Pjeçi, i cili ishte ngarkuar me detyrë dhe kishte kryer veprimet me katër të shoqëruarit, përbën shkelje të dispozitave të akteve normative në fuqi dhe konkretisht:

1. Nenit 109, pika 5, e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku parashikohet se:

“Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar”.

2. Kreut VII, gërma a.3, të Procedurës Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, “Procedura e dokumentimit të veprimit të shoqërimit” parashikohet:

“a.3 - Procesverbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:”

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 - Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Procesverbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësive policore”.

Theksojmë se, edhe fakti që OPGJ Arben Pjeçi nuk e dinte që në të tilla raste mbahej ky dokument në dy kopje dhe njëra prej tyre u jepej të shoqëruarit, është shqetësues dhe duhet vlerësuar seriozisht sepse kjo shkelje mund të përsëritet edhe herë të tjera prej tij dhe nga punonjësit e tjerë të këtij komisariati.

Është rasti që të sjellim në vëmendje përmbajtjen e nenit 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Polinë e Shtetit” ku parashikohet se:

“Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”.

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës dhe imazhit të Policisë së Shtetit, si dhe rritjen e besimit të publikut tek ky organ, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në gërmën “d” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar,

REKOMANDOJMË

1. Fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit të policisë, oficerit të policisë gjyqësore Arben Pjeçi, efektiv i Komisarariatit të Policisë Durrës.

2. Përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës me qëllim mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

3. Trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë së shtetit dhe njohjen e tyre me aktet normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi me synim respektimin e të drejtave të shtetasve.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi